



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2019

PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR
NDËRTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE RUAJTJEN E VARREZAVE TË
DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kombëtare për dëshmorët e atdheut ndërtohen varreza ku prehen dëshmorët e atdheut.
2. Varrezat e dëshmorëve të atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe si të tilla trajtohen dhe mbrohen si monument kulture, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin publik të varrimit dhe për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.
3. Varrezat e reja të cilat do të shërbejnë si vend prehjeje për personat që gëzojnë statusin “Dëshmor i atdheut”, krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- 3.1 Deklarimi pasuri kulturore i varrezave të reja që gëzojnë statusin “Dëshmor i atdheut” bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Administrimi i vlerave kulturore të varrezave monumentale bëhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.
4. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë institucionet përgjegjëse për projektimin dhe ndërtimin e varrezave të reja të dëshmorëve të atdheut.
5. Mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave të dëshmorëve të atdheut kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6. Në çdo varrezë të dëshmorëve të atdheut përcaktohen shërbimet e ruajtjes, kontrollit dhe kujdestarisë gjatë gjithë kohës së funksionimit të tyre, sipas akteve ligjore në fuqi për administrimin e varrimit dhe për trashëgiminë kulturore.

7. Ndërtimi, zgjerimi, mbyllja apo prishja e varrezës së dëshmorëve të atdheut apo të parcelave ku gjenden varret e dëshmorëve të atdheut, bëhet në pajtim me projektin për zhvillimin e varrezave të dëshmorëve dhe planin e përgjithshëm vendor të zhvillimit urban, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në çdo rast projekti kalon për shqyrtim dhe miratim pranë strukturave kompetente të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
 8. Në rastet kur normat e radioaktivitetit janë tej normave të lejuara, atëherë mbetjet mortore të personit të shpallur "Dëshmor i atdheut", në bashkëpunim me organet kompetente, do të trajtohen sipas rregullave ligjore dhe teknike për mbrojtjen nga rrezatimet radioaktive.
 9. Materialet e gërmuara dhe mbeturinat e dala gjatë meremetimit dhe ndërtimit të varreve të reja në varrezën e dëshmorëve të atdheut duhet të transportohen jashtë varrezave, jo më vonë se një ditë pas datës së përfundimit të punimeve. Materialet për kryerjen e punimeve të ndryshme duhen të jenë të parapërgatitura dhe të vendosen në zona të miratuara nga struktura përkatëse e bashkisë.
 10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

MINISTRI I MBROJTJES

Olta Xhaçka

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE RUAJTJEN E VARREZAVE TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e organeve përgjegjëse dhe procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019. Projektvendimi është një detyrim ligjor që rrjedh nga pika 2, e nenit 13, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është i domosdoshëm, pasi përcakton autoritetet përgjegjëse për ndërtimin e varrezave të reja, të cilat do të shërbejnë si vend prehje për personat që gëzojnë statusin e “Dëshmorit të atdheut”, përcakton mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut.

Në projektvendim është përcaktuar Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore si institucionet përgjegjëse për ndërtimin e varrezave të dëshmorëve të atdheut. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 25.4.2002 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, nuk ka detajuar në mënyrë të hollësishme ministrinë dhe institucionet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, varrezat ku prehen dëshmorët e atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si monument kulture, ky status është përcaktuar gjithashtu edhe në ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, i ndryshuar, si përfundim në projektakt

është parashikuar edhe Ministria e Kulturës, e cila ka përgjegjësinë e saj në trajtimin e varrezave monumentale si monument kulture, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Aktualisht mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve të atdheut bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 25.4.2002 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, i cili është miratuar në mbështetje të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Me miratimin e ligjit të ri nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, pika 2, e nenit 13 të tij, ngarkon Këshillin e Ministrave për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut.

Në projektvendim ministrinë të cilat janë përgjegjëse për ndërtimin e varrezave të reja të dëshmorit të atdheut janë: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme si dy ministrinë kryesore, të cilat në fushën e përgjegjësisë së tyre shtetërore kanë aktivitetet me rrezik të lartë, ku rritet probabiliteti i incidenteve fatale dhe ku ka humbur jetën gjatë ushtrimit të detyrës i ndjeri apo ka lidhje aktiviteti shoqëror i të ndjerit. Sipas pikës nr. 4 të projektvendimit ndërtimi i varrezave të reja të dëshmorit të atdheut bëhet në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Sipas pikës 8, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018, varrezat e dëshmorëve të atdheut mbajnë statusin e varrezës monumentale dhe trajtohen si monument kulture. Si rrjedhim në projektvendim është përcaktuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme, edhe Ministria e Kulturës për ndërtimin dhe administrimin e varrezave të dëshmorëve të atdheut si ministria përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe ruajtjen monumenteve të kulturës. Ky detyrim rrjedh edhe nga neni 3/c, i ligjit nr. 9220/2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore për trashëgiminë kulturore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Kulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË
HARTIMIN E PROJEKTAKTIT


Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe stafi teknik i Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmorë i atdheut".

Projektvendimi dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Kulturës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Efektet financiare do të parashikohen rast pas rasti në projektaktet me të cilin krijohen varrezat monumentale të reja dhe në shtesat e mundshme të reja.

MINISTRI I MBROJTJES


Olta Xhaçka